



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Në bazë të nenit 11,12 dhe 40.2"ç" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 dhe nenin 41.2 "ç" të Statutit të komunës, si dhe Vendimit të KK-së 01.Nr.269/12, dt.27.09.2012 me të cilin aprovohet buxheti i Komunës së Vushtrrisë, KAB-i dhe lista e projekteve prioritare për vitin 2013, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 28.02.2013, mori këtë:

**VENDIM
PËR SHPËRNDARJEN E MJETEVE NGA FONDI PËR TRANSFERE DHE
SUBVENCIONE**

Neni 1

1.1. Me këtë vendim, mjetet buxhetore të komunës – fondi për transfere dhe subvencione për vitin 2013, në shumën prej 30.000 € (për klube sportive) ndahen si më poshtë:

• Kl. Basketbollit " Kosova "	5.000 €;
• Kl. Volejbollit " Kosova " – femrat	2.000 €;
• Kl. Hendbollit " Kosova " – meshkujt	3.000 €;
• Kl. Hendbollit " Kosova " – femrat	1.500 €;
• KV "AS Vushtrria "	1.000 €;
• KF " Artakolli "	2.000 €;
• KB " Vushtrria Basket "	1.000 €;
• K Shahut " Llamkos "	800 €;
• K Shahut " Shqiponja "	800 €;
• K Volejbollit " Gjimnazisti "	2.000 €;
• Kl. Mundjes " Kosova "	500 €;
• Kl. Boksit " Kosova "	800 €;
• Kl. Ping Pongut " Hasan Prishtina "	500 €;
• KF " Kosova "	2.000 €;
• KF "Vicianum"	1.000 €;
• KK Box " Kosova "	1.000 €;
• KH " Samadrexha " (F + M)	3.500 €;
• Tifozët " FORCA "	500 €;
• Shoqata e Peshkatarëve " Sitnica "	300 €;
• Shoqata e Pedagogëve të Kulturës Fizike	300 €;
• Muhamet Rama – veteran i atletikës	300 €;
• Shoqata e të Shurdhëve	200 €.

Gjithsej 30.000 €.

Neni 2

Mjetet në shumën e cekur si në nenin paraprak, të shpërndahen në bazë të kriterëve dhe kushteve të përcaktuara me Rregulloren për Përcaktimin e Kriterëve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione për Ndihmë Momentale Entiteteve Publike dhe Jopublike 01Nr.37-2/11, dt.24.02.2011, si dhe pas dorëzimit të raportit nga përfituesit e këtij fondi për shfrytëzimin e mjeteve nga viti 2012.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, si dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

The seal is circular with a blue border. The outer ring contains the text 'REPUBLIKA E KOSOVES' at the top and 'KOMUNA E VUSHTRRIS' at the bottom. Inside the ring is a smaller circle containing the text 'REPUBLIKA E KOSOVES' at the top and 'KOMUNA E VUSHTRRIS' at the bottom. In the center of the seal is the coat of arms of the Municipality of Vushtrri, which features a shield with a white background, a blue border, and a central emblem. The text 'KOMUNA E VUSHTRRIS' is written in a smaller font below the coat of arms.

Kryesuesi i Kuvendit

Habib Mustafa



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 31/13

Nr. i fq. / Br. sf - 1 -

Data: / Datum 28. 02. 2013

VUSHTRRI - VUÇITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Në bazë të nenit 40.2, pika "c" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, nenit 40.2 "dh", dhe 41.2 "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 28.02.2013, mori këtë:

V E N D I M

Për bartjen e mjeteve të pashfrytëzuara (të lira dhe të zotuar) nga të hyrat vetanake, nga viti 2012 në vitin 2013

Neni 1

Me këtë vendim barten mjetet e lira të mbetura nga viti 2012 në vitin 2013, në shumën prej 440,227.43 €. Shpërndarja bëhet në kategoritë ekonomike.

Neni 2

Shuma e mjeteve të bartura në kategorinë e pagave dhe mëditjeve (kodi 111), në shumën prej 28,076.21 €.

Shuma e mjeteve të bartura-mallra dhe shërbime (kodi 130), në shumën 45,461.24 €.

Shuma e mjeteve të bartura – subvencione dhe transfere (kodi 200), në shumën prej 17,440.00 €.

Shuma e mjeteve të bartura – shpenzimet kapitale (kodi 300), në shumën 349,249.98 €.

Gjithsej..... 440,227.43 €.

Neni 3

Mjetet e lira barten sipas nenit 2 dhe tabelës, e cila është shtojcë e këtij vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

Habib Mustafa





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 30/13

Nr. i fq. / Br. st - 1 -

Data: / Datum 28. 02. 2013

VUSHTRRI - VUÇITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Në bazë të nenit 11, 12 dhe 17 "c" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, dhe nenit 41.2 "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, si dhe në bazë të dispozitave të Rregullores për shërbimin e transportit me "merimangë" për territorin e Komunës së Vushtrrisë 01 Nr.139/11, dt. 30.06.2011, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 28.02.2013, mori këtë:

V E N D I M

Për caktimin e lokacionit për shërbimet me auto-merimangë

Neni 1

Me këtë vendim caktohet lokacioni për kryerjen e shërbimeve me auto-merimangë (auto-park) në ngastrën kadastrale **P-70202010-00583-1**, me kulturë "kullosë kl. e IV" me sipërfaqe prej 10,057 m², e cila evidentohet në certifikatën pronësore **UL-70202010-00087**, ZK-Bukosh, pronë e Komunës së Vushtrrisë.

Neni 2

Certifikata pronësore dhe kopja e planit janë pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe të bashkangjitura në shtojcë.

Neni 3

Kryerja e shërbimeve me auto-merimangë do të bëhet konform Rregullores për shërbimet e transportit me auto-merimangë në Komunën e Vushtrrisë.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Shërbime Publike.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Neni 6

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi 01 Nr.79/12, dt.30.04.2012.

Kryesuesi i Kuvendit



Habib Mustafa